REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, 15 shkurt 2021
Nr. ref.:RK 1707/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI229/19

Parashtrues

Organizata Joqeveritare "Asociacioni për Kulturë, Edukim dhe Arsim AKEA"

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës ARJ-UZVP.nr. 109/2019 të 7 tetorit 2019, si dhe Aktvendimeve të Ministrisë së Administratës Publike nr.02/2014 të 23 tetor 2014, nr.05/2015 të 16 dhjetorit 2015, nr.06/470-3/2016 të 8 nëntorit 2016, dhe Ref.KSHA-OJQ/4-2018, të 25 shtatorit 2018

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar.

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Organizata Joqeveritare "Asociacioni për Kulturë, Edukim dhe Arsim AKEA" e cila para Gjykatës përfaqësohet nga avokatët, Arianit Koci dhe Nora H. Veliu nga Prishtina (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston kushtetutshmërinë e Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës [ARJ-UZVP.nr. 109/2019] të 7 tetorit 2019 (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme), si dhe Aktvendimit të Ministrisë së Administratës Publike (në tekstin e mëtejmë: MAP) nr.02/2014 të 23 tetor 2014, Aktvendimit të MAP-it nr.05/2015 të 16 dhjetorit 2015, Aktvendimit të MAP-it nr.06/470-3/2016 të 8 nëntorit 2016, dhe Aktvendimit të MAP-it Ref.KSHA-OJQ/4-2018, të 25 shtatorit 2018.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve të kontestuara, me të cilat pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me nenin 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për një Gjykim të Drejtë] nenin 44 [Liria e Asociimit], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës], nenin 54 [Mbrojta Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), si dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt), nenin 11 (Liria e tubimit dhe organizimit), nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit) dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 (Mbrojtja e Pronës) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 21 dhe paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 17 dhjetor 2019, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 20 dhjetor 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Safet Hoxha Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Radomir Laban (kryesues), Remzie Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.

7. Më 15 janar 2020, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme dhe MAP-it.

8. Më 13 shkurt 2020, Gjykata kërkoi nga MAP që të dorëzojë në Gjykatë Vendimin me të cilin kanë hequr pezullimin e vendosur ndaj ushtrimit të veprimtarisë së parashtruesit të kërkesës.

9. Më 2 mars 2020, MAP njoftoi Gjykatën se më 10 tetor 2019, Departamenti i OJQ-ve i MAP ka rikthyer statusin aktiv të parashtruesit të kërkesës pasi nga

nxjerrja e Vendimit [nr. 06-108/2018] të datës 10 gusht 2018 përmes të cilit ishte vazhduar pezullimi i veprimtarisë së parashtruesit të kërkesës kishte kaluar një vit..

10. Më 20 janar 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe me shumicë votash i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Parashtruesi i kërkesës parashtron kërkesë në Gjykatë për herë të dytë.

12. Në vazhdim, Gjykata do të bëjë përmbledhjen e fakteve lidhur me kërkesën e tanishme KI229/19 si dhe me kërkesës e parë KI18/19 për aq sa ato ndërlidhen edhe me kërkesën e tanishme.

13. Më 9 dhjetor 2004, parashtruesi i kërkesës ishte regjistruar si Organizatë Jo-Qeveritare në Kosovë.

Përmbledhja e fakteve lidhur me pezullimin e parë të fushëveprimtarisë së parashtruesit të kërkesës

14. Më 17 shtator 2014, MAP mori Vendimin [nr. 06/270/2014], me të cilin pezulloi veprimtarinë e parashtruesit të kërkesës, me arsyetimin se kishte një kërkesë të tillë nga një organ i sigurisë, duke theksuar se ekzistonte dyshimi i bazuar se veprimtaria që e ushtron parashtruesi i kërkesës, nuk përkon me rendin juridik-kushtetues të Republikës së Kosovës.

15. Më 24 shtator 2014, parashtruesi i kërkesës ndaj Vendimit [nr. 06/270/2014] të MAP-it, të 17 shtatorit 2014, kishte paraqitur ankesë në Komisionin për Shqyrtimin e Ankesave të OJQ-ve (në tekstin e mëtejmë: Komisioni i Ankesave).

16. Më 23 tetor 2014, Komisioni i Ankesave nxori Vendimin [nr. 2/14], me të cilin e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar.

17. Më 18 nëntor 2014, parashtruesi i kërkesës parashtroi padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, kundër Vendimit të MAP-it [nr. 06/270/2014], të 17 tetorit 2014, si dhe Vendimit të Komisionit të Ankesave, [nr. 02/2014] të 23 tetorit 2014.

18. Më 9 nëntor 2017, Gjykata Themelore në Prishtinë nxori Aktgjykimin [A.nr.2345/2014], me të cilin aprovoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës dhe anuloi vendimin e Komisionit të Ankesave [Nr. 02/2014] të 23 tetorit 2014 lidhur me Vendimin e MAP-it [nr. 06/270/2014], dhe e ktheu rastin në rishqyrtim. Në këtë Aktgjykim ndër të tjera arsyetohet se në Vendimin [nr. 2/14], e Komisionit të Ankesave, të 23 tetorit 2014, nuk është sqaruar në mënyrë konkrete dhe nuk janë vërtetuar faktet se në çfarë mënyre veprimtaria e ushtruar nga parashtruesi i kërkesës, nuk përkon me rendin juridik-kushtetues të Republikës së Kosovës.

19. Më 18 janar 2018, parashtruesi parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit [A.nr.2345/2014] të Gjykatës Themelore të 9 nëntorit 2017, duke pretenduar se Gjykata Themelore nuk ka pasur të drejtë ta kthejë rastin në rivendosje në MAP, por ka qenë e obliguar që të konstatojë paligjshmërinë e Vendimit [nr. 06/270/2014] të MAP dhe ta anulojë atë si absolutisht të pavlefshëm, të paligjshëm dhe të pabazuar në ligj. Ndër të tjera parashtruesi i kërkesës theksoi se duke pasur parasysh Ligjin 04/L-57 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare, i njëjti njeh vetëm themelimin dhe mbylljen e një organizate joqeveritare, dhe jo pezullimin.

20. Më 13 shtator 2018, Gjykata e Apelit nxori Aktgjykimin [AA. nr. 76/18], me të cilin ankesa e parashtruesit të kërkesës ishte pranuar si e bazuar dhe anuloi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore të 9 nëntorit 2017, ndërsa çështja u kthye në rivendosje në Gjykatën Themelore me arsyetimin se dispozitivi i Aktgjykimit të Gjykatës Themelore ishte *"i paqartë dhe i pa ekzekutueshëm si dhe me një arsyetim pa i dhënë përgjigje pretendimeve të palëve në procedurë"*.

21. Më 9 dhjetor 2018, Gjykata Themelore, duke vepruar në pajtim me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të 13 shtatorit 2018, nxori Aktgjykimin [A. nr. 2369/2018], me të cilin sërish aprovoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, anuloi vendimin e Komisionit të Ankesave [nr. 02/2014] të 23 tetorit 2014, lidhur me Vendimin e MAP-it [nr. 06/270/2014] dhe e ktheu rastin në rishqyrtim në MAP.

22. Në një datë të pasaktësuar, parashtruesi i kërkesës, paraqiti ankesë në Gjykatën e Apeli, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore [A.nr.2369/2018], të 9 dhjetorit 2018 *"për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale"*, si dhe duke ripërsëritur pretendimet, se Gjykata Themelore nuk ka pasur të drejtë ta kthejë rastin në rivendosje në MAP por ka qenë e obliguar që të konstatojë paligjshmërinë e Vendimit [nr. 06/270/2014] të MAP të anulojë atë si absolutisht të pavlefshëm, të paligjshëm dhe të pabazuar në ligj, mes tjerash, duke pasur parasysh që Ligji 04/L-57 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare njeh vetëm themelimin dhe mbylljen e një organizate joqeveritare, dhe jo pezullimin.

23. Më 1 shkurt 2019 parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë kërkesën KI18/19 duke kontestuar kushtetutshmërinë pezullimit të fushëveprimtarisë së saj duke përfshirë Aktvendimin e MAP KSHA-OJQ/4-2018, te 25 shtatorit 2018, që ndërlidhet me procedurën e katërt të pezullimit të fushëveprimtarisë së parashtruesit të kërkesës.

24. Më 20 qershor 2019, Gjykata përmes Aktvendimit për papranueshmëri në rastin KI18/19, refuzoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës si të papranueshme pasi konstatoi se nuk ishin shterur mjetet juridike. Parashtruesi i kërkesës ishte ende në pritjen e vendimeve lidhur me procedurat administrative dhe gjyqësore lidhur me suspendimin për një vit të fushëveprimtarisë së parashtruesit të kërkesës të vitit 2014 si dhe për procedurat që ndërlidheshin me vazhdimin e suspendimit të fushëveprimtarisë së parashtruesit të kërkesës të vitit 2018. Andaj, Gjykata erdhi në konstatimin se parashtruesi nuk kishte shterur mjetet juridike në dispozicion. Gjykata erdhi

në këtë konstatim pasi vlerësoi gjithashtu se, përkundër pretendimeve të parashtruesit të kërkesës se mjetet juridike të parapara me ligj nuk janë efektive në praktikë, sipas natyrës së tyre dhe rezultateve në procedurën e deritanishme mjetet juridike ishin efektive, ndoshta jo në mënyrën dhe masën në të cilën parashtruesi i kërkesës e kishte pritur, sepse efektiviteti i mjetit juridik nuk përcaktohet në bazë të faktit nëse parashtruesi i kërkesës me përdorimin e tij arriti të realizoj qëllimin e tij në mënyrë si ai do të donte, por nëse ai e kishte pasur mundësinë që me mjetin juridik që ai përdor të paraqiste argumentet që do të shqyrtoheshin nga autoritet kompetente.

25. Më 24 qershor 2019, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [AA.nr.137/2019] e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore [A.nr.2369/2018] të 19 dhjetorit 2018. Gjykata e Apelit ndër të tjera arsyetoi se Gjykata Themelore *"ka nxjerrë prova të mjatueshme të cilat vërtetojnë se [Vendimi i Komisionit të Ankesave [nr.02/2014] përmban të meta të cilat pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së tij"* andaj më tutje Gjykata e Apelit thekson se, Gjykata Themelore ka vendosur drejtë kur ka kthyer rastin në rishqyrtim në MAP.

26. Ndaj Aktgjykimit [AA.nr.137/2019] të Gjykatës së Apelit parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit në Gjykatën Supreme.

27. Më 7 tetor 2019, Gjykata Supreme përmes Aktvendimit [ARJ-UZVP.nr.109/2019] e hodhi poshtë si të palejuar kërkesën e parashtruesit të kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit me arsyetimin se ky mjet i jashtëzakonshëm juridik nuk lejohet në rastet kur vendimi *"nuk është bërë i plotfuqishëm"* dhe arsyetoi se në rastin konkret rasti i parashtruesit të kërkesës përmes vendimit të Gjykatës Themelore, të vërtetuar edhe nga Gjykata e Apelit, ishte rikthyer ne rivendosje në organin administrativ. Në dosjen e lëndës nuk ka informata nëse Vendimi i Komisionit të Ankesave [nr.02/2014] është rishqyrtuar.

Lidhur me pezullimin e dytë të fushëveprimtarisë së parashtruesit të kërkesës

28. Më 26 tetor 2015, MAP nxori vendimin [nr. 06/342/2015] me të cilin pezulloi veprimtarinë e parashtruesit të kërkesës, me arsyetimin se kishte një kërkesë të tillë nga një organ i sigurisë, *për shkak të dyshimeve rreth veprimtarisë së parashtruesit të kërkesës.*

29. Më 24 nëntor 2015, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë pranë Komisionit të Ankesave, ndaj Vendimit të MAP-it [nr. 06/342/2015].

30. Më 16 dhjetor 2015, Komisioni i Ankesave mori vendimin [Nr. KRZ-OJQ/5-2015], me të cilin ka refuzuar ankesën e parashtruesit si të pabazuar. Nga dosja e rastit nuk vërehet nëse parashtruesi i kërkesës ka iniciuar procedurë gjyqësore lidhur me këtë vendim për pezullim.

Lidhur me pezullimin e tretë të fushëveprimtarisë së parashtruesit të kërkesës

31. Më 8 nëntor 2016, MAP nxori vendimin [nr. 06/470-3/2016], me të cilin vazhdoi pezullimin e aktiviteteve të parashtruesit të kërkesës.

32. Më 24 nëntor 2016, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Komisionin e Ankesave kundër vendimit të MAP-it [nr. 06/470-3/2016]. Në dosje nuk ka informata nëse parashtruesi i kërkesës ka pranuar vendim lidhur me këtë ankesë.

Lidhur me pezullimin e katërt të fushëveprimtarisë së parashtruesit të kërkesës

33. Më 10 gusht 2018, MPA nxori vendimin [nr.06-108/2018], me të cilin sërish vazhdoi pezullimin e veprimtarisë së parashtruesit të kërkesës.

34. Më 18 shtator 2018, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Komisionin e Ankesave të OJQ-ve, ndaj vendimin të MAP-it, të 10 gushtit 2018.

35. Më 19 shtator 2018, parashtruesi i kërkesës parashtroi pranë Institucionit të Avokatit të Popullit *"Kërkesë për hapjen e rastit të OJQ-së AKEA"* kundër Ministrisë së Administratës Publike".

36. Më 25 shtator 2018, Komisioni i Ankesave mori vendimin [KSHA/OJQ/nr. 4-2018] me të cilin refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar.

37. Më 1 nëntor 2018, parashtruesi i kërkesës parashtroi në Gjykatën Themelore padi për anulimin e Vendimit të Komisionit të Ankesave [nr. 4-2018], të 25 shtatorit 2018 dhe kërkesë për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të MAP [nr.06-108/2018] dhe vendimit të Komisionit të Ankesave [nr. 4-2018], të 25 shtatorit 2018.

38. Më 19 dhjetor 2018, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatën Themelore parashtresë për plotësimin e padisë dhe kërkesës për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të Komisionit të Ankesave [nr. 4-2018], të 25 shtatorit 2018.

39. Më 4 janar 2019, Gjykata Themelore nxori Aktvendimin [A. nr. 2859/18], me të cilin refuzoi kërkesën e parashtruesit për shtyrjen e ekzekutimit të Vendimit të Komisionit të Ankesave [nr. 4-2018], të 25 shtatorit 2018.

40. Më 30 janar 2019, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit ndaj vendimit të Gjykatës Themelore [A.nr.2859/18].

41. Më 18 mars 2019, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [AA.nr/130/2019] refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës ndaj Aktvendimit të Gjykatës Themelore [A.nr.2859/18] lidhur me kërkesë e parashtruesit për shtyrjen e ekzekutimit të Vendimit të Komisionit të Ankesave [nr. 4-2018], të 25 shtatorit 2018.

42. Më 1 prill 2019, Avokati i Popullit lëshoi një raport me rekomandime lidhur me ankesën e parashtruesit të kërkesës. Në raport, Avokati i Popullit ka konstatuar se *"subjekti aktiviteti i të cilit është pezulluar i shkelet e drejta për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm për shkak të zvarritjes në vendosjen e rastit, të përcaktuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) neni 54 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe nenin 13 të KEDNJ-së."*

43. Në Raportin e tij me rekomandime, Avokati i Popullit gjithashtu i rekomandoi Qeverisë së Republikës së Kosovës *"Ta ndryshojë Udhëzimin Administrativ nr. 02/2014 për Regjistrimin dhe Funksionimin e Organizatave Joqeveritare, i miratuar në mbledhjen e 195-të të Qeverisë së Kosovës, me Vendimin nr. 01/195, i datës 3.9. 2014, përkatësisht fshirjen e nenit 18".*

44. Më 24 prill 2019, Ligji nr. 06/l- 043 për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare, u shpall në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

45. Më 10 tetor 2019, MAP hoqi pezullimin e vendosur ndaj veprimtarisë së parashtruesit të kërkesës, respektivisht, Departamenti për OJQ i MAP, riktheu si aktiv statusin juridik të parashtruesit të kërkesës. MAP sqaroi se statusi aktiv i parashtruesit të kërkesës u kthye si aktiv pasi Vendimi [nr.06-108/2018] për pezullimin e katërt të parashtruesit të kërkesës *"nuk ishte më në fuqi, pas kalimit të afati[t] prej 1 vit[i]."*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

46. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimet e kontestuara parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me nenin 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit],nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për një Gjykim të Drejtë] nenin 44 [Liria e Asociimit], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës], nenin 54 [Mbrojta Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, si dhe nenin 6 (e drejta për një proces të rregullt), nenin 11 (Liria e tubimit dhe organizimit), nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit) dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ.

Lidhur me të drejtën për një gjykimit të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ, të drejtën për mbrojtje juridike të garantuar me nenin 54 të Kushtetutës dhe parimin e ndarjes së pushtetit të paraparë me nenin 4 të Kushtetutës

47. Pretendimin për shkelje të së drejtës për një gjykim të drejtë dhe të drejtën për mbrojtje juridike, parashtruesi i kërkesës i ndërlidh me Aktgjykimin [A. nr. 2369/2018] të Gjykatës Themelore, të 9 dhjetor 2018, Aktgjykimin [AA.nr.137/2019] të Gjykatës së Apelit të 24 qershor 2019 dhe Aktvendimin [ARJ-UZVP.nr109/2019] të Gjykatës Supreme të 7 tetor 2019. Këto procedura gjyqësore ndërlidhen me procedurën e parë për pezullimin e veprimtarisë së parashtruesit përmes Vendimit të MAP [nr. 06/270/2014] të konfirmuar me Vendimin e Komisionit të Ankesave (nr.02/2014).

48. Lidhur me këtë, parashtruesi i kërkesës fillimisht ankohet lidhur me Aktgjykimin [A. nr. 2369/2018] të Gjykatës Themelore të konfirmuar me Aktgjykimin [AA.nr.137/2019] të Gjykatës së Apelit, me të cilin rasti i parashtruesit të kërkesës lidhur me padinë për anulimin e Vendimit të MAP [nr. 06/270/2014] të konfirmuar me Vendimin e Komisionit të Ankesave (nr.02/2014), ishte rikthyer ne rishqyrtim në MAP. Ai pretendon se Gjykata e Themelore dhe Gjykata e Apelit, duke mos vendosur në mënyrë "meritore" për të shpallur të paligjshëm Vendimin e Komisionit të Ankesave (nr.02/2014), por duke kthyer rastin në rivendosje në Komisionin e Ankesave i kanë shkelur të drejtën për një gjykim të drejtë dhe për mbrojte juridike të të drejtave.

49. Sa i përket Aktvendimit [ARJ-UZVP.nr.109/2019] të Gjykatës Supreme, parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme - sipas arsyetimit te dhënë - fillimisht nuk bënë dallimin ndërmjet një vendimi "jomeritor" dhe një vendimi "meritor". Se dyti, Gjykata Supreme nuk bën dallimin ndërmjet një vendimi të plotfuqishëm dhe të formës së prerë dhe një vendimi i cili nuk është i tillë. Duke u thirrur në paragrafët 4 dhe 5 të nenit 4 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës pretendon se bazuar në parimin kushtetues për ndarjen e pushteteve, është plotësisht e gabuar të thuhet se një vendim "jomeritor" i gjykatës së shkallës së dytë, me të cilin një çështje i kthehet organit administrativë në rivendosje, nuk është vendim i formës së prerë dhe i plotfuqishëm. *"Kjo do të vlente vetëm për një vendim të gjykatës së shkalles së dytë, me të cilin çështja i kthehet gjykatës së shkalles së parë në rivendosje - pra, KY realisht s'do te ishte një vendim i përfundimtar, i formës së prerë dhe i plotfuqishëm lidhur me çështjen, ngase - pasi gjykata e shkallës së parë të vendos sërish lidhur me çështjen përkatëse, palët do të kishin të drejtë të parashtronin sërish ankesë pranë gjykatës së shkallës së dytë dhe të pranonin një vendim të ri".*

50. Parashtruesi më tej thekson se Gjykata Kushtetuese, në jurisprudencën e saj, është thirrur disa here në parim kushtetues të ndarjes së pushteteve duke cituar rastin KO98/11. Prandaj, Gjykata Supreme, me konstatimin e saj se *"një vendim jomeritor i gjykatës i cili anulon aktin administrativ dhe e kthen çështjen në rivendosje tek organi administrativ - nuk është i formës se prerë dhe i plotfuqishëm"* [...] shkeli parimin e ndarjes së pushteteve.

51. Njëkohësisht, Gjykata Supreme, me Aktvendimin me të cilin hodhi kërkesën e parashtruesit të kërkesës si të palejuar, duke mos i trajtuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës, po ashtu shkeli të drejtën e parashtruesit në gjykim te drejtë, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe të drejtën për mbrojtje gjyqësore të të drejtave, të garantuar me nenin 54 i Kushtetutës.

52. Parashtruesi i kërkesës tutje shton se shkelja e se drejtës në gjykim të drejtë dhe shkelja e të drejtës së organizatës në mbrojtje gjyqësore të të drejtave - nga ana e gjykatave te rregullta, ka mundësuar që shkelja e Lirisë së Asociimit nga ana e MAP-it të mos korrigjohet dhe të mos parandalohet për pese (5) vite me radhë.

Lidhur me shkeljet e pretenduara të nenit 24 [Barazia para Ligjit], nenit 44 [Liria e Asociimit], nenit 46 [Mbrojtja e Pronës], të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe nenit 11 (Liria e

tubimit dhe organizimit), nenit 14 (Ndalimi i diskriminimit) dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 (Mbrojtja e Pronës) të KEDNJ-së

53. Shkeljen e të drejtave të lartcekura parashtruesi i kërkesës i ndërlidh me pezullimin e fushëveprimtarisë së parashtruesit të kërkesës nga viti 2014 deri në vitin 2019, kur edhe është suspenduar pezullimi i fushëveprimtarisë së parashtruesit të kërkesës. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimet arbitrare, të kundërligjshme dhe antikushtetuese të organit administrativ të MAP-it të vitit 2014 dhe më tej, konkretisht me vendimin e katërt të MAP-it [aktvendimi i MPA Ref. KSHA-OJQ/4-2018] të 25 shtatorit 2018 i është shkelur liria e asociimit sipas nenit 44 të Kushtetutës në lidhje me nenin 11 të KEDNJ-së.

54. Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon se në periudhën që nga viti 2014, organizata nuk kryen asnjë nga aktivitetet e saj për shkak të vendimeve të lartpërmendura të organit administrativ të MAP-it, aktivitetet e organizatës pezullohen përkohësisht për një periudhë një (1) vjeçare, me arsyetimin se janë në përputhje me kërkesën e organit kompetent të sigurisë dhe aktivitetet janë në kundërshtim me qëllimin dhe fushëveprimin e punës së organizatës dhe që, si të tilla, janë në kundërshtim me interesat e sigurisë së Republikës së Kosovës. Duke vepruar kështu, Autoriteti Menaxhues i MAP-it ka shkelur nenin 55 para. 1 të Kushtetutës, sipas të cilit të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë mund të kufizohen vetëm me ligj.

55. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës, për të arsyetuar pretendimet e tij për shkeljet e pretenduara të nenit 44 të Kushtetutës dhe nenin 11 të KEDNJ-së, ka përmendur një numër të caktuar të vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ). Në mesin e tyre janë aktgjykimet e GJEDNJ-së *Partia e Bashkuar Komuniste dhe të tjerët kundër Turqisë*, kërkesa 133/1996/752/951, vendimi i 30 janarit 1998 dhe *Zhechev kundër Bullgarisë* kërkesa nr. 57045/00, vendimi i 21 qershorit 2007.

56. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon që me vendimet arbitrare, të paligjshme dhe antikushtetuese të organit qeverisës të MAP-it nga viti 2014 e tutje, dhe në veçanti me vendimin e katërt të MAP-it (Aktvendimi i MAP-it Ref. KSHA-OJQ/4-2018) të 25 shtatorit, është shkelur neni 24. 2 i Kushtetutës në lidhje me nenin 14 të KEDNJ-së.

57. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se me vendimin e kontestuar është shkelur e drejta e gëzimit paqësor të pronës, të garantuar me nenin 46.3 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

58. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i referohet në këtë pjesë një numri të aktgjykimeve të GJEDNJ-së me qëllim të ndërtimit të pretendimeve të tij për shkeljen e nenit 24. para. 2 të Kushtetutës në lidhje me nenin 14 të KEDNJ-së, si dhe shkeljen e nenit 46.3 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

59. Parashtruesi më tej pretendon se i ka shteruar të gjitha mjetet juridike që i kishte në dispozicion në lidhje me vendimin e parë të MAP-it të 23 tetorit 2014 me të cilin për herë të parë është pezulluar veprimtaria e organizatës e që

ndërlidhet me Aktvendimin [ARJ-UZVP.nr.109/2019], të 7 tetorit 2019, të Gjykatës Supreme. Megjithatë, që nga 20 nëntori 2014, kur ai parashtroi padi kundër MAP-it dhe deri më 1 shkurt 2019, Gjykata Themelore në Prishtinë ende nuk ka nxjerrë një vendim meritor lidhur me ligjshmërinë e Aktvendimit të MAP-it të vitit 2014.

60. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata Kushtetuese që çështjen që e ka paraqitur në këtë kërkesë ta shqyrtojë ngjashëm me praktikën gjyqësore të saj në rastet: KI06/10; KI11/09; KI99/14 dhe KI100/14 dhe në pajtim me nenin 54 të Kushtetutës, nenin 13 të KEDNJ-së dhe nenin 2 të Protokollit nr. 4 të KEDNJ-së.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

61. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe të përcaktuara me Rregullore të punës.

62. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
>
> *[...]*
>
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."*

63. Gjykata gjithashtu i referohet paragrafit 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme."*

64. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të paraqesë ankesë kushtetuese, duke u thirrur në shkelje të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të tij, që vlejnë për individët dhe personat juridikë për aq sa janë të zbatueshme (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI41/09, parashtruesi i kërkesës Universiteti AABRIINVESTL.L.c., Aktvendimi për papranueshmëri i 3 shkurtit 2010, paragrafi 14).

65. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit, që përcakton:

Neni 47 i Ligjit
[Kërkesa individuale]

"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individi mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

66. Gjykata shqyrton gjithashtu nëse janë përmbushur kriteret e përcaktuara me nenin 49 [Afatet] të Ligjit dhe rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë], respektivisht paragrafin (1) (b) dhe (c) të Rregullores së punës. Ato përcaktojnë si në vijim:

Neni 49 i Ligjit
[Afatet]

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...".

Rregulli 39 i Rregullores së punës
[Kriteret e pranueshmërisë]

"(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

[...]
b) janë shteruar të gjitha mjetet efektive të përcaktuara me ligj kundër aktgjykimit ose vendimit të kontestuar;
[...]."

67. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar i cili konteston akte të autoriteteve publike, përkatësisht Aktvendimin e Gjykatës Supreme [ARJ-UZVP.nr. 109/2019] të 7 tetorit 2019, si dhe Aktvendimin e MAP-it nr.02/2014 të 23 tetor 2014, Aktvendimin e MAP-it nr.05/2015 të 16 dhjetorit 2015, Aktvendimin e MAP-it nr.06/470-3/2016 të 8 nëntorit 2016, dhe Aktvendimin e MAP-it Ref.KSHA-OJQ/4-2018, të 25 shtatorit 2018. Parashtruesi i kërkesës konteston aktet e lartcekura, që ndërlidhen me pezullimin e parë, të dytë, të tretë dhe të katërt të fushëveprimtarisë së parashtruesit të kërkesës, ashtu si është sqaruar tek faktet e rastit, me ç'rast për secilën këtyre grupeve të procedurave janë nxjerr vendime të ndryshme administrative dhe gjyqësore, duke pretenduar se, pavarësisht se parashtruesit të kërkesës momentalisht i është hequr pezullimi i fushëveprimtarisë, pezullimi i fushëveprimtarisë së parashtruesit nga viti 2014 deri në vitin 2019 ka qenë i paligjshëm dhe në kundërshtim me të drejtat e tij kushtetuese.

68. Andaj, Gjykata në vazhdim duhet të vlerësoj nëse parashtruesi i kërkesës ka shterur mjetet juridike të parapara me ligj, për secilin grup të procedurave, në mënyrë që Gjykata të mund të shqyrtoj pretendimet e parashtruesit të kërkesës

për shkelje të të drejtave kushtetuese, si rezultat i pezullimit të fushëveorimtarisë së parashtruesit nga viti 2014 deri në vitin 2019.

69. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton se rregulli për shterimin e mjeteve juridike sipas nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 47 të Ligjit dhe rregullit 39 (1) (b) të Rregullores së punës i obligon ata që dëshirojnë të paraqesin rastin e tyre në Gjykatën Kushtetuese që së pari duhet të shfrytëzojnë mjetet juridike efektive në dispozicion në pajtim me ligjin, kundër një aktgjykimi ose vendimi të kontestuar.

70. Në këtë mënyrë, gjykatave të rregullta u jepet mundësia që të korrigjojnë gabimet e tyre përmes procedurave gjyqësore të rregullta para se rasti të vijë në Gjykatën Kushtetuese. Ky rregull bazohet në supozimin e shprehur në nenin 32 të Kushtetutës dhe nenin 13 të KEDNJ-së, që në legjislacionin vendës ka mjete juridike në dispozicion për t'u shfrytëzuar pranë gjykatave të rregullta në lidhje me shkeljen e pretenduar, pavarësisht nëse dispozitat e KEDNJ-së janë inkorporuar në të drejtën nacionale apo jo (shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ *Aksoy kundër Turqisë*, Aktgjykimit i 18 dhjetorit 1996, paragrafi 51).

71. Parimi i shterjes së mjeteve juridike nënkupton që mekanizmi për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese i krijuar nga Gjykata Kushtetuese të jetë subsidiar në raport me sistemin e rregullt gjyqësor që mbron të drejtat e njeriut (shih, *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNJ *Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i GJEDNJ-së i 7 dhjetorit 1976, paragrafi 48).

72. Në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës duhet të ketë mjete juridike të cilat janë në dispozicion dhe të mjaftueshme që sigurojnë një mundësi për të korrigjuar shkeljet e pretenduara. Ekzistimi i mjeteve juridike në fjalë duhet të jetë mjaft i sigurt jo vetëm në teori, por edhe në praktikë, dhe nëse nuk është kështu, atëherë këtyre mjeteve juridike do t'iu mungojë disponueshmëria dhe efektiviteti i nevojshëm (shih, *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNJ *Vernillo kundër Francës*, Aktgjykim i 20 shkurtit 1991, paragrafi 27, dhe *Dalia kundër Francës*, Aktgjykim i GJEDNJ-së i 19 shkurtit 1998, paragrafi 38).

73. Gjykata duhet të shqyrtojë nëse janë shteruar mjetet juridike dhe nëse mjeti juridik ishte efektiv, në dispozicion në teori dhe praktikë në kohën përkatëse, përkatësisht, që ka qenë i qasshëm, që ka mundur t'i korrigjojë shkeljet në lidhje me kundërshtimet e parashtruesit të kërkesës, dhe gjithashtu ka ofruar një perspektivë të arsyeshme për sukses (shih, *mutatis mutandis*, *Civet kundër Francës* paragrafët 42-44 të Aktgjykimit të GJEDNJ-së, të 28 shtatorit 1999).

74. Megjithatë, kur një mjet juridik parashikohet me ligj, i takon parashtruesit të kërkesës të dëshmojë se mjeti juridik i paraparë me ligj është shteruar me të vërtetë ose për ndonjë arsye nuk ka qenë në dispozicion dhe ka qenë joefektiv në rrethanat e posaçme të rastit, ose ka pasur rrethana të veçanta për shkak të të cilave ai ose ajo kanë qenë të liruar nga kushti i shterimit të mjeteve juridike.

75. Në këtë kontest, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës përsërit në kërkesën e tanishme të njëjtën pretendim që kishte ngritur në kërkesës KI18/19, duke theksuar se mjetet juridike të parapara me ligj nuk ishin efektive për të

adresuar pretendimet e tij për shkelje të të drejtave kushtetuese. Në këtë aspekt Gjykata i referohet Aktvendimit të saj KI18/19 që kishte vlerësuar se në rastin e parashtruesit të kërkesës ai kishte në dispozicion mjete efektive juridike lidhur me rastin e tij dhe ku në mënyrë specifike ishte theksuar se *"sipas natyrës së tyre dhe rezultateve në procedurën e deritanishme mjetet juridike ishin efektive, ndoshta jo në mënyrën dhe masën në të cilën parashtruesi i kërkesës e kishte pritur, sepse efektiviteti i mjetit juridik nuk përcaktohet në bazë të faktit nëse parashtruesi i kërkesës me përdorimin e tij arriti të realizoj qëllimin e tij në mënyrë si ai do të donte, por nëse ai e kishte pasur mundësinë që me mjetin juridik që ai përdor të paraqiste argumentet që do të shqyrtoheshin nga autoritet kompetente."* (Shih rastin e Gjykatës KI18/19, Aktvendim për papranueshmëri, i 20 qershorit 2019, paragrafi 92).

76. Andaj, duke pasur parasysh që Gjykata përmes Aktvendimit për papranueshmëri KI18/19, konstatoi se parashtruesi kishte në dispozicion mjete juridike efektive, nuk e sheh të nevojshme që të trajtoj sërish këtë pretendim në mënyrë specifike.

77. Rrjedhimisht, Gjykata në vazhdim do të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës lidhur me vendimet e kontestuara ka shterur mjetet juridike, duke pasur parasysh edhe vendimet që janë nxjerrë nga organet administrative dhe gjyqësore lidhur me rastin e parashtruesit të kërkesës nga koha kur parashtruesi ka paraqitur kërkesën KI18/19 në Gjykatë, deri në paraqitjen e kërkesës së tanishme. Gjykata do të bëjë këtë vlerësim duke analizuar ndaras, nëse parashtruesi i kërkesës i ka shterur mjetet juridike për procedurat me të cilat parashtruesit i është pezulluar fushëvperimtaria në vitin 2014 (procedura e parë për pezullimin e fushëveprimtarisë së parashtruesit të kërkesës) dhe lidhur me procedurat për vazhdimin e këtij pezullimi në vitin 2015 , 2016 dhe 2018 (procedurat për pezullimin e dytë, të tretë dhe të katërt të fushëveprimtarisë së parashtruesit të kërkesës).

Lidhur me Aktvendimin e MAP-it nr.05/2015 të 16 dhjetorit 2015, Aktvendimin e MAP-it nr.06/470-3/2016 të 8 nëntorit 2016, dhe Aktvendimin e MAP-it Ref.KSHA-OJQ/4-2018, të 25 shtatorit 2018 (procedurat për pezullimin e dytë, të tretë dhe të katërt të fushëveprimtarisë së parashtruesit të kërkesës)

78. Lidhur me këtë, Gjykata rikujton se Aktvendimi i MAP-it nr.05/2015 i 16 dhjetorit 2015, Aktvendimi i MAP-it nr.06/470-3/2016 i 8 nëntorit 2016, dhe Aktvendimin i MAP-it Ref.KSHA-OJQ/4-2018, i 25 shtatorit 2018, të cilat parashtruesi i kërkesës i konteston para Gjykatës ndërlidhen me pezullimin e dytë, të tretë dhe të katërt të fushëveprimtarisë së parashtruesit të kërkesës, ashtu si është sqaruar tek faktet e rastit më lart.

79. Lidhur me Vendimin e MAP-it nr.05/2015 të 16 dhjetorit 2015, që është vendimi i Komisionit të Ankesave që kishte vendosur lidhur me ankesën e parashtruesit ndaj Vendimit të MAP [nr. 06/342/2015] të 26 tetorit 2015, me të cilin ishte pezulluar fushëveprimatria e parashtruesit **për herë të dytë**, Gjykata vëren se në dosje nuk ka informata nëse parashtruesi i kërkesës ka filluar procedurat gjyqësore lidhur me këtë vendim për pezullim.

80. Lidhur me Aktvendimin e MAP-it nr.06/470-3/2016 të 8 nëntorit 2016 me të cilin ishte pezulluar fushëveprimatria e parashtruesit **për herë të tretë**, më 24 nëntor 2016, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Komisionin e Ankesave. Në dosje nuk ka informata nëse parashtruesi i kërkesës ka pranuar vendim lidhur me këtë ankesë.

81. Lidhur me Vendimin [nr.06-108/2018], të MAP të 10 gushtit 2018, me të cilin ishte pezulluar fushëveprimatria e parashtruesit të kërkesës **për herë të katërt**, më 25 shtator 2018, Komisioni i Ankesave mori vendimin [KSHA/OJQ/nr. 4-2018] me të cilin refuzoi ankesën e parashtruesit, ndaj Vendimin [nr.06-108/2018], si të pabazuar. Parashtruesi i kërkesë kishte filluar procedurat gjyqësore lidhur me ligjshmërinë e vendimeve të lartcekura në Gjykatën Themelore duke parashtruar padi si dhe kishte kërkuar nga Gjykata Themelore që të vendos lidhur me shtyrjen e ekzekutimit të vendimeve të lartcekura. Gjykata rikujton se më 4 janar 2019, Gjykata Themelore nxori Aktvendimin [A. nr. 2859/18], me të cilin refuzoi kërkesën e parashtruesit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të Komisionit të Ankesave [nr. 4-2018], të 25 shtatorit 2018. Më 30 janar 2019, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit ndaj vendimit të Gjykatës Themelore [A.nr.2859/18].Më 18 mars 2019, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [AA.nr/130/2019] refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës ndaj Aktvendimit të Gjykatës Themelore [A.nr.2859/18] lidhur me shtyrjen e ekzekutimit të vendimit për pezullim. Pas kërkesës KI18/19 së dorëzuar në Gjykatë, më 20 qershor 2019, Gjykata përmes Aktvendimit për papranueshmëri në rastin KI18/19, gjeti se parashtruesi i kërkesës ishte ende në pritjen e vendimeve lidhur me procedurat administrative dhe gjyqësore (padinë) lidhur me ligjshmërinë e vendimeve për pezullimin e katërt të parashtruesit të kërkesës.

82. Ndërsa më 10 tetor 2019, MAP hoqi pezullimin e vendosur ndaj veprimtarisë së parashtruesit të kërkesës, respektivisht, Departamenti për OJQ i MAP, riktheu si aktiv statusin juridik të parashtruesit të kërkesës. MAP sqaroi se statusi aktiv i parashtruesit të kërkesës u kthye si aktiv pasi Vendimi [nr.06-108/2018] për pezullimin e katërt të parashtruesit të kërkesës *"nuk ishte më në fuqi, pas kalimit të afati[t] prej vit[i]."* Megjithatë, parashtruesit të kërkesës edhe pse i është rikthyer statusi aktiv për të ushtruar fushëveprimtarinë e saj nga data 10 tetor 2019, ai nuk ka dorëzuar në Gjykatë ndonjë vendim me të cilin është vendosur lidhur me padinë për ligjshmërinë e vendimit me të cilin ishte pezulluar fushëveprimtaria e parashtruesit të kërkesës për herë të katërt, respektivisht nga 10 gushti 2018 deri më 10 tetor 2019.

83. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se, lidhur me Aktvendimin e MAP-it nr.05/2015 të 16 dhjetorit 2015, Aktvendimin e MAP-it nr.06/470-3/2016 të 8 nëntorit 2016, dhe Aktvendimin e MAP-it Ref.KSHA-OJQ/4-2018, të 25 shtatorit 2018, të cilat i konteston para Gjykatës, që ndërlidhen me pezullimin e dytë, të tretë dhe të katërt të fushëveprimtarisë së parashtruesit të kërkesës parashtruesi i kërkesës nuk i ka shterur mjetet juridike të parapara me ligj, qoftë në procedurë administrative ose/dhe në procedurë gjyqësore.

84. Si përfundim lidhur me këtë pjesë të kërkesës, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës, lidhur me aktvendimet e lartcekura nuk i plotëson kriteret e pranueshmërisë pasi që nuk ka shteruar mjetet juridike siç është

përcaktuar në paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, paragrafin 2 të nenit 47 të Ligjit dhe pikës (b) të paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës, dhe si e tillë, kjo pjesë e kërkesës duhet të deklarohet e papranueshme.

Lidhur me Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës ARJ-UZVP.nr. 109/2019 të 7 tetorit 2019, që ndërlidhet me procedurën e parë të pezullimit të fushëveprimtarisë së parashtruesit të kërkesës përmes Vendimin të MAP [nr. 06/270/2014] të 17 shtator 2014 (procedurat për pezullimin e parë të fushëveprimtarisë së parashtruesit të kërkesës)

85. Në këtë aspekt, Gjykata rithekson se parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin [A. nr. 2369/2018] të Gjykatës Themelore, të 9 dhjetor 2018, e cila kishte kthyer rastin e parashtruesit të kërkesës, lidhur me pezullimin e fushëveprimtarisë së tij, për rishqyrtim në MAP, dhe i cili vendim ishte konfirmuar me Aktgjykimin [AA.nr.137/2019] të Gjykatës së Apelit të 24 qershorit 2019.

86. Lidhur me këtë, parashtruesi i kërkesës e konteston faktin që Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit, duke mos vendosur në mënyrë "meritore" për të shpallur të paligjshëm Vendimin e Komisionit të Ankesave (nr.02/2014), por duke kthyer rastin në rivendosje në Komisionin e Ankesave i kanë shkelur të drejtën për një gjykim të drejtë dhe për mbrojte juridike të të drejtave.

87. Për të kontestuar Aktgjykimin e lartcekur të Gjykatës Themelore dhe asaj të Apelit, parashtruesi i kërkesës kishte bërë kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit para Gjykatës Supreme e cila me Aktvendimin [ARJ-UZVP.nr109/2019] të Gjykatës Supreme të 7 tetor 2019 hodhi poshtë si të palejuar kërkesën e parashtruesit të kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit me arsyetimin se ky mjet i jashtëzakonshëm juridik nuk lejohet në rastet kur vendimi *"nuk është bërë i plotfuqishëm"*.

88. Lidhur me Aktvendimin e Gjykatës Supreme parashtruesi i kërkesës pretendon se bazuar në parimin kushtetues për ndarjen e pushteteve, është plotësisht e gabuar të thuhet se një vendim "jomeritor" i gjykatës së shkallës së dytë, me të cilin një çështje i kthehet organit administrativë në rivendosje, nuk është vendim i formës së prerë dhe i plotfuqishëm. Andaj, parashtruesi pretendon se Gjykata Supreme gabimisht nuk e ka trajtuar Aktgjykimit e Gjykatës së Apelit të formës së prerë, dhe ka hedhur poshtë kërkesën si të palejuar.

89. Lidhur me këtë Gjykata rikujton Aktvendimin [ARJ-UZVP.nr109/2019] e Gjykatës Supreme e cila në arsyetimin për shpalljen e kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor si të palejuar, theksoi se *"Me aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit AA.nr.137/2019 dt 24.06.2019, është vërtetuar Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamentit Administrativ A.U.nr.2369/2018 dt 09.12.2018, me të cilin është aprovuar si e bazuar kërkesëpadia e paditësit (AKEA) Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave të OJQ-ve nr 02/2014 dt.23.10.2014, dhe çështja i është kthyer organit të paditur-të padituës në rishqyrtim dhe rivendosje. Meqenëse, vendimi gjyqësor nuk është bërë i plotfuqishëm pasi që lënda i është kthyer*

organit administrativ në rishikim, kjo Gjykatë e ka hedhur kërkesën si të palejueshme".

90. Në këtë drejtim, Gjykata gjithashtu vë ne pah se Ligji për Konfliktet Administrative, përkatësisht nenin 24, përcakton:

"Neni 24

1. *Kundër vendimit të formës së prerë të gjykatës kompetente për çështje administrative të shkallës së dytë, pala mund të parashtrojë Gjykatës Supreme të Kosovës kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor.*
2. *Kërkesa nga paragrafi 1. i këtij neni mund të parashtrohet vetëm për shkak të shkeljes të drejtës materiale ose shkeljeve të dispozitave të procedurës, që do të mund të kishte ndikim në zgjidhjen e çështjes.*
   [...]"

91. Gjykata po ashtu rikujton se neni 63 [Dispozita të tjera të procedurës] i Ligji për Konfliktet Administrative përcakton se: *"Nëse ky ligj nuk përmban dispozita për procedurën në konfliktet administrative, do të zbatohen përshtatshmërisht dispozitat e ligjit për procedurën kontestimore."*

92. Në këtë aspekt, Gjykata i referohet nenit 166 [Forma e prerë e aktgjykimit] të Ligjit nr.03/L-006 për Procedurë Kontestimore, që parasheh se:

> *"Aktgjykimi i cili nuk mund të goditet me anë të ankesës bëhet i formës së prerë për aq sa është vendosur me të mbi kërkesëpadinë apo të kundërpadisë."*

93. Andaj, Gjykata thekson se Gjykata Supreme kishte shpallur si të palejuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës për faktin se çështja e parashtruesit të kërkesës lidhur me vendimet e MAP nuk ishte zgjidhur në mënyrë meritore nga Gjykata Themelore dhe ajo e Apelit, në kuptimin e asaj që këto vendime nuk ishin të plotfuqishme lidhur me çështjen administrative për të cilën ishte inicuar konflikti administrativ, pasi çështja lidhur me kërkesëpadinë ishte rikthyer në rishqyrtim në organet administrative dhe nuk ishte vendosur përfundimisht për ligjshmërinë e vendimeve administrative.

94. Lidhur me këtë, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës, pavarësisht që ka ndjekur procedurat ligjore për të kontestuar gjetjet e Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë [A.nr.2369/2018] të 19 dhjetorit 2018, para Gjykatës së Apelit dhe asaj Supreme, nuk i ka shterur mjetet juridike për të parashtruar kërkesës para Gjykatës për faktin se me Aktgjykimin [AA.nr.137/2019] të Gjykatës së Apelit të 24 qershor 2019, është vërtetuar Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, me të cilin është vendosur se çështja nëse vendimi për pezullimin e parë të veprimtarisë së parashtruesit të kërkesës i vitit 2014 është i ligjshëm, kthehet në rivendosje në MAP dhe çështja lidhur me ligjshmërinë e vendimit për pezullimin e parë të veprimtarisë së parashtruesit të kërkesës nuk është zgjidhur përfundimisht.

95. Ndërsa Gjykata thekson se pretendimet kryesore të parashtruesit që ndërlidhet me shkeljen e pretenduar të lirisë së sasocimit, kanë të bëjnë pikërisht me ligjshmërinë e vendimeve të cilat do të jenë objekt shqyrtimi në MAP, lidhur me të cilat parashtruesi argumenton kërkesës e tij kryesore. Kjo pasi Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [AA.nr.137/2019] vërtetoi se Gjykata Themelore ka vepruar drejtë kur ka konstatuar se Vendimi i Komisionit të Ankesave [nr.02/2014] përmban të meta të cilat pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së tij dhe se Gjykata Themelore ka vendosur drejtë kur ka kthyer rastin në rishqyrtim në MAP. Ndërsa Gjykata Supreme përmes Aktvendimit [ARJ-UZVP.nr.109/2019] e hodhi poshtë si të palejuar kërkesën e parashtruesit të kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit. Ndërsa, në dosjen e lëndës nuk ka informata nëse Vendimi i Komisionit të Ankesave [nr.02/2014] është rishqyrtuar. Andaj, çështja e ligjshmërisë së pezullimit të aktivitetit të parashtruesit të kërkesës sipas vendimit nr.02/2014, është ende e hapur para organeve administrative.

96. Lidhur me këtë, Gjykata bazuar në praktikën e saj gjyqësore thekson se nëse procedurat janë në zhvillim e sipër pranë gjykatave e rregullta, atëherë kërkesat e parashtruesve në Gjykatën Kushtetuese konsiderohen të parakohshme (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës, *Leutrim Hajdari*, Aktvendim për papranueshmëri i 5 shkurtit 2019, paragrafi 41; KI23/10, parashtruese *Jovica Gadžić*, Aktvendim për papranueshmëri, i 19 shtatorit 2013, paragrafi 47; dhe KI102/16, parashtrues *Shefqet Berisha,* Aktvendim për papranueshmëri, i 2 marsit 2017, paragrafi 39).

97. Andaj, në rrethanat e rastit konkret, bazuar në parimin e subsidiaritetit, Gjykata është e detyruar që kërkesën e parashtruesit ta shpallë të papranueshme si të parakohshme, gjegjësisht për arsye se nuk janë shteruar mjetet juridike efektive në rastin e tij.

98. Megjithatë, Gjykata konsideron se, pavarësisht nga procedurat që janë në zhvillim e sipër tek gjykatat e rregullta dhe pa paragjykim ndaj atyre procedurave, asgjë nuk e ndalon parashtruesin e kërkesën që në të ardhmen sërish të dorëzojë kërkesë kushtetuese brenda afatit ligjor katër mujor nga dita që ka pranuar vendimin përfundimtar në rastin e tij nga gjykatat e rregullta.

99. Andaj, Gjykata vlerëson se kërkesa e parashtruesit shpallet e papranueshme, në pajtim me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, paragrafin 2 të nenit 47 të Ligjit dhe specifikohet më tej përmes pikës (b) të paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

Përfundim

100. Si përfundim, duke pasur parasysh atë që u tha më lart, Gjykata vlerëson se kërkesa e parashtruesit lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë se Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës ARJ-UZVP.nr. 109/2019 të 7 tetorit 2019, si dhe Aktvendimeve të Ministrisë së Administratës Publike nr.02/2014 të 23 tetor 2014, nr.05/2015 të 16 dhjetorit 2015, nr.06/470-3/2016 të 8 nëntorit 2016, dhe Ref.KSHA-OJQ/4-2018, të 25 shtatorit 2018, është e papranueshme pasi parashtruesi i kërkesës nuk i ka shterur mjetet juridike të parapara me Ligj.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (b) të Rregullores së punës, më 20 janar 2021, me shumicë votash

VENDOS

I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Safet Hoxha

Arta Rama-Hajrizi